



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. _____, datë _____2024

**PËR MIRATIMIN E PLANEVE TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMIVE PYJORE
“PANARIT-TRESKË”, “PËRPARIMAJ-DARDHË”, “VOSKOPOJË”, “VOSKOPOJË2”,
“ZËMBLAK – QARR” DHE EKONOMISË KULLOSORE “RUNGAJË”.**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave si dhe në mbështetje të nenit 3, nenit 8, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “a”, nenit 27 pika 5, nenit 55 pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 115 datë 31.07.2014 “Për ndarjen Administrativo-Territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, pika 2, shkronja “b” të ligjit nr. 57, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, nenit 14 të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar, Vendimit nr. 433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/bashkive”, të ndryshuar:

V E N D O S I

1. Të miratojë në parim planet e mbarështimit të ekonomive pyjore “Panarit – Treskë”, “Përparimaj – Dardhë”, “Voskopojë”, “Voskopojë 2”, “Zëmbiak – Qarr”, dhe ekonomisë kullosore “Rungajë”, sipas dokumentacionit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave për ndjekjen e procedurave të mëtejshme për miratimin e planeve të mbarështimit, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

K R Y E T A R

ANA VERUSHI

Miratuar me _____vota
Vota Pro_____

Vota Kundër_____

Vota Abstenim_____

Zbardhur më datë_____